

## Fjalori i Eficiencës së Energjisë

<b>Energjia</b>	Energjia është aftësia për të prodhuar, ndryshuar ose bërë punë, psh: Energji që prodhon dritë, Energji që prodhon nxehtësi, Energji karburantesh, Energji që krijon tinguj, Energji e fuqisë së proçeseve teknologjike.
<b>Energjia fillestare</b>	Energji e cila nuk ka pësuar transformim apo shndërrim ( nafta, qymyri uji, era etj)
<b>Energjia sekondare</b>	Energjia fillestare e transformuar me qëllim që të transportohet
<b>Energjia përfundimtare</b>	Energjia që i dërgohet konsumatorit final (psh elektriciteti)
<b>Eficienca e Energjisë</b>	Ulje e konsumimit të energjisë për njësi prodhimi apo njësi shërbimi por duke ruajtur ose përmirësuar kushtet e jetesës dhe kushtet e punës dhe në të njëjtën kohë duke ruajtur ose përmirësuar cilësinë e shërbimeve ose të proçeseve të prodhimit.
<b>Burimet e parinovueshme (jo të ripërtëritshme) të energjisë</b>	Përfshijnë lëndët djegëse fosile – qymyr, naftë, gaz natyror, propan dhe uranium. Quhen fosile sepse janë formuar nga mbetjet organike të bimëve dhe kafshëve parahistorike Ato përdoren për të prodhuar energji elektrike, për automjetet dhe për të prodhuar produkte të ndryshme. Quhen të tilla sepse nuk mund të ripërtërihen në një periudhë të shkurtër kohe.
<b>Burimet e rinovueshme (të ripërtëritshme) të energjisë</b>	Përfshijnë energjinë e biomasës, baticës, gjeotermale, hidrike, solare dhe të erës. Quhen burime të rinovueshme sepse ripërtërihen brenda një kohe të shkurtër. Ditë pas dite dielli shkëlqen, era fryn dhe lumenjtë rrjedhin. Kryesisht burimet e energjisë së rinovueshme përdoren për të prodhuar elektricitet.



## **Energjia hidrike**

Energjia hidrike (hidro do të thotë ujë) është energji e krijuar nga forca e lëvizjes së ujit. Rënia dhe lëvizja e ujit është pjesë e një cikli të vazhdueshëm natyror që quhet cikli i ujit. Energjia diellore shkakton avullimin e ujit të oqeanëve dhe lumenjve. Kur avujt e ujit arrijnë shtresat e ftohta të ajrit në atmosferë ndodh kondesimi dhe krijimi i reve. Pastaj kjo lagështirë bie në tokë në formën e shiut ose borës, duke zëvendësuar përsëri ujin në oqeanë dhe lumenj. Graviteti shtyn ujin duke e lëvizur nga vende më të larta në vende më të ulta. Forca e lëvizjes së ujit mund të jetë shumë e fuqishme, në varësi të shpejtësisë së rrjedhjes, lartësisë dhe sasisë së ujit. Energjia hidrike është burim i rinovueshëm sepse uji në tokë ripërtërihet vazhdimisht nga rënia e shiut/dëborës

## **Energjia diellore**

Qelizat diellore e shndërrojnë dritën direkt në elektricitet. Dallojmë 2 lloje të ndryshme teknologjie të përdorimit të energjisë diellore:

-Panelet diellore termale (sistemet diellore për ngrohjen e ujit që transformojnë energjinë e përfituar nga energjia diellore në energji termike për ngrohjen e ujit)

-Sistemet fotovoltaike (për prodhimin e energjisë elektrike).

## **Energjia e erës**

Energjia e erës mund të përdoret duke ndërtuar një kullë të lartë me një helikë të madhe. Era vë helikën në lëvizje, e cila pastaj ndez gjeneratorin dhe kështu prodhohet energji. Zakonisht këto kulla ngrihen në grupe duke krijuar “ferma ere” për të prodhuar më shumë elektricitet.

## **Biomasa**

Përbërje organike – dru, drithëra, alga, mbetjet e produkteve bujqësore si psh farat e frutave, ullirit, kallinjët e grurit etj që mund të përdoren si burim energjie. Biomasa e merr energjinë nga dielli. E gjithë lënda organike përmban energji të grumbulluar nga dielli. Gjatë një procesi të quajtur fotosintezë, drita e diellit u jep bimëve energjinë



e nevojshme për të shndërruar ujin dhe dioksidin e karbonit në oksigjen dhe sheqerna. Këto sheqerna, të quajtura karbohidrate, furnizojnë bimët dhe kafshët bimëngrënëse me energji.

**Burimet  
gjeotermike**

Burime ujore të ngrohta të shtresave nëntokesore të tokës, të cilat kanë një temperaturë të mjaftueshme për tu përdorur si burime energjie (psh burimet termale të Peshkopisë. Janë burime të rinovueshme të energjisë.

**Xhuli (J)**

Është njësia standarde ndërkombëtare e përdorur për matjen e energjisë, Një xhaul (J) është i barabartë me një vat për sekondë (një vat është i barabartë me një xhaul për sekondë); një kilovat-orë është saktësisht 3.6 mega xhaul.

**Ngrohja globale**

Ngrohja globale i referohet rritjes së temperaturës mesatare të atmosferës së Tokës dhe të oqeanëve, të cilat filluan të rriten në fund të shekullit të 19-të si pasojë e pranisë më të madhe të “gazeve serë” në atmosferë, të cilët shërbejnë si një “jorgan i ngrohtë ” për planetin tonë. Rritja e temperaturës mesatare të Tokës ka bërë që të kemi dimra dhe vera më të ngrohta, thatësira të gjata, përmytje, etj.

**Efekti serrë**

Efekti natyror serrë i referohet një procesi natyror gjatë të cilit gazra të ndryshëm formojnë një lloj ‘batanije’ rreth tokës, që njihet si atmosfera, e cila shërben për të izoluar dhe mbajtur nxehtësinë. Gazrat që krijojnë efektin serrë janë: dioksidi i karbonit, metani dhe protoksid azoti. Pa efektin natyror serrë, temperatura mesatare e tokës do të ishte -18°C, dhe jo temperatura aktuale mesatare +15 °C. Përqëndrimet e këtyre gazrave kanë mbetur në nivel konstant për mijëra vjet. Kohët e fundit, çlirimi i gazrave që krijojnë efektin serrë është rritur ndjeshëm për shkak të aktivitetit njerëzor. Energjia përdoret vazhdimisht – në shtëpi, në punë, për udhëtim – duke djegur gjithmonë e më shumë karburant, si: qymyr, naftë dhe gaz, të cilat çlirojnë sasi të mëdha gazrash që krijojnë efektin serrë dhe



zmadhojnë 'batanijen' e gazrave që rrethojnë tokën.

**Llambat  
inkandeshente**

Burimi më i zakonshëm i dritës, llamba qelqi me një fije të hollë brenda. Afërsisht nëntëdhjetë për qind (90%) e energjisë së konsumuar nga një llambë e tillë harxhohet më tepër si nxehtësi sesa si dritë.

**Llambat  
fluoreshente**

Llambat fluoreshente janë deri në pesë herë më efikase se llambat inkandeshente, dhe zgjasin deri në njëzet herë më shumë. Llambat fluoreshente janë të formave të ndryshme, si tuba të drejtë, tuba rrethore, llambat fluoreshente kompakte.

**Etiketa e energjisë**

Qysh nga viti 1998, Direktiva Europiane, ka parashikuar në mënyrë të detyrueshme prezencën e të ashuquajtures „etiketë energjetike“ në frigorifera, ngrirësa, furra, lavatrice dhe larëse enësh. Në etiketën energjetike janë vendosur shigjeta te ngjyrosura, ku çdonjëra nga të cilat i përket niveleve te ndryshme të eficencës. Etiketa e energjisë tregon sa efikase është pajisja në përdorimin e energjisë elektrike, në një shkallë nga A në G. A-ja tregon nivelet më të ulta të konsumit, G-ja ato më të lartat, dhe gërmat e tjera tregojnë nivelet e ndërmjetme. Gjithashtu, marka Ecolabel tregon që ajo pajisje respekton ambientin.

**Energy Star**

Një standard ndërkombëtar për produktet e konsumit të energjisë efikase me origjinë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Produktet që kanë këtë etiketë përdorin 20-30% më pak energji sesa produktet e tjera.

**Vlera -U**

Vlera -U është një matje e rrjedhjes së nxehtësisë. Sa më e ulët të jetë vlera U aq më ngadalë e transferon një material nxehtësinë brenda dhe jashtë një ndërtese.



**COP**

COP- Koeficienti i Performancës-raporti i inputeve të energjisë me outputet e saj

**Pompë nxehtësie**

Pajisje elektrike qe merr nxehtësinë nga një vend dhe e transferon në një vend tjetër

